



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	15.12.2025
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Nëntor

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 01.11.2025 deri me 30.11.2025

Lipjan 2025

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Gjatë muajit nëntor, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka vazhduar me zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve të planifikuara për këtë periudhë, duke u fokusuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe ofrimit të shërbimeve sa më efikase për qytetarët.

Gjatë këtij muaji ka përfunduar montimi i serave, si projekt i përbashkët me organizatën QATAR Charity. Nga ky projekt kanë përfituar gjithsej 90 familje, kryesisht familje me kushte të vështira socio-ekonomike.

Po ashtu, në bashkëpunim me organizatën QATAR Charity, janë hapur 12 puse në fshatin Medvec, për familje me gjendje të rëndë socio-ekonomike.

Gjatë muajit nëntor, komisioni për përzgjedhjen e mekanizmit bujqësor ka shqyrtuar të gjitha lëndët dhe ka përzgjedhur përfituesit për mekanizëm të ndryshëm bujqësor, si: freza, spërkatëse dhe shpërndarëse të plehut mineral. Numri total i përfituesve nga ky projekt është 250, ndërsa shpërndarja e mekanizmit pritet të realizohet gjatë muajit dhjetor.

Në kuadër të përmirësimit të kushteve të qasjes në zonat bujqësore, është realizuar zhavorrimi i rrugës në fshatin Hanrovc. Ky projekt ka filluar gjatë muajit nëntor dhe pritet të përfundojë së shpejti. Ky investim do të lehtësojë qarkullimin e mjeteve bujqësore dhe transportin e produkteve, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të kësaj zone.

Gjithashtu, Drejtoria ka zhvilluar takime dhe vizita në terren me disa organizata të huaja që veprojnë në Kosovë, me qëllim të identifikimit të mundësive për projekte të reja në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Përmes këtyre bashkëpunimeve synohet sigurimi i fondeve shtesë, si dhe rritja e kapaciteteve profesionale të fermerëve përmes trajnimeve dhe asistencës teknike.

Operatori ekonomik është duke vazhduar me intervenimet për trajtimin dhe menaxhimin e qenve endacakë, sipas kërkesave të qytetarëve në lagje të ndryshme të Komunës së Lipjanit. Këto veprime kanë për qëllim përmirësimin e sigurisë publike dhe krijimin e një ambienti më të qetë për banorët.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, gjatë muajit nëntor, ka treguar përkushtim të vazhdueshëm në zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorit bujqësor dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve.